



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE



MIRATOHET
KRYETARI
GENTIAN SALA

UDHËZIM

PËR PËRCAKTIMIN

**E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR THIRRJET PËR APLIKIM TË PROJEKT-PROPOZIMEVE
NË FUSHËN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për thirrje për aplikim në mbështetje të projekt-propozimeve në fushën e mediave audiovizive miratohet ky udhëzim.

1. Pas miratimit të projekt-buxhetit vjetor nga AMA, drejtoritë/njësitë e AMA-s paraqesin tek titullari i institucionit, kërkesë për fillimin e procedurave për thirrjet për aplikim për projekt-propozime në fushën e mediave audiovizive.
2. Kërkesa sipas pikës 1 më sipër, duhet të përmbajë ndër të tjera informacionin e mëposhtëm:
 - a) aspektet për të cilat kërkohet bashkëpunim në fushën e realizimit të projekteve mbiregulluar audioviziv;
 - b) propozimi për përmbajtjen e thirrjes për aplikim që përmban tematikën e fushave ku shpreh interes AMA për sinergji në realizimin e projekteve;
 - c) propozime për kalendarin e publikimit të thirrjes për aplikim.
3. Titullari i institucionit pas miratimit të kërkesës për thirrje për aplikim, ngre Komisionin për ndjekjen e procedurës, i përbërë nga jo më pak se 5 anëtarë, nga të cilët 3 anëtarë duhet të jenë nëpunës të drejtorisë/njësisë propozuese.
4. Komisioni për ndjekjen e procedurës, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e daljes së urchrit, harton dhe miraton:
 - formularin për aplikim;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- kriteret që duhet të përmbushë pala e interesuar;
 - afatin përfundimtar dhe vendin për depozitim të projekt-propozimeve, i cili nuk duhet të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga data e publikimit.
5. Komisioni për ndjekjen e procedurës shpall publikisht në faqen zyrtare të AMA-s, dokumentacionin e cituar në pikën 4 si dhe udhëzuesin për projekt-propozime, sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Dokumentat e mësipërme janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.
6. Komisioni për ndjekjen e procedurës në datën dhe orën e përcaktuar si afat përfundimtar për depozitim të projekt-propozimeve merr në dorëzim nga nëpunësi I protokollit projekt-propozimet e dorëzuara nga aplikuesit. Procesi i vlerësimit të projektpropozimeve do të realizohet në dy faza të cilat duhet të përfundojnë brenda 15 ditësh nga data e paraqitjes së aplikimeve:
- 6.1 faza e parë do të jetë vlerësimi i dokumentacionit ligjor dhe propozimin financiar të subjektit aplikues;
- 6.2 faza e dytë do të jetë vlerësimi i aktiviteteve të propozuara në fushën e mediave audiovizive të cilat përfshijnë: studime tregu, evente shkencore kombëtare ose ndërkombëtare, aktivitete kualifikuese dhe trajnuese me redaksitë e mediave audiovizive, si dhe publikime ose përkthim nga literatura bashkëkohore mbi performancën e tregut audioviziv si dhe trendet e zhvillimit të tij brenda Shqipërisë apo në vende të tjera.
7. Komisioni për ndjekjen e procedurës shqyrton përputhshmërinë e projektpropozimeve, ndër të tjera sipas standardit të mëposhtëm:
- veprimtaria e deritanishme si dhe projekti i propozuar ka në objekt të veprimtarisë së tij median audiovizive;
 - objektivat e projektit të propozuar përputhen me politikat dhe strategjitë e Autoritetit të Mediave Audiovizive;
 - misioni i subjektit aplikues duhet të përputhet me politikat dhe strategjitë e Autoritetit të Mediave Audiovizive;
 - subjektit aplikues ka përvoja të suksesshme me partnerë e donatorë të tjerë;
 - subjektit aplikues ka kapacitetin në terma të burimeve njerëzore dhe ekspertizën teknike për të zbatuar/menaxhuar projektin.
 - origjinaliteti i projektit dhe cilësia e aktiviteteve të planifikuara;
 - aktivitetet e planifikuara përputhen me objektivat e projektit dhe hapat e zbatimit të projektit janë të qarta;
 - treguesit e përzgjedhur për matjen e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara janë të përshtatshëm;
 - përpilimi i kostove financiare: kostot të jenë reale (çmimet të jenë të bazuara në referenca dhe të detajuara, ku aplikanti duhet t'i argumentojë dhe t'i justifikojë).
 - qëndrueshmëria e projektit: sa afatgjatë është impakti i projekt-propozimit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- respektimi i të drejtës së autorit në të gjitha fazat – konceptim, hartim dhe zbatim – të projektit të propozuar.
8. Grupi i punës pasi analizon projekt-propozimet, përgatit relacionin përmbledhës për procedurën e ndjekur duke i propozuar titullarit projektin/projektet fitues të procedurës, për të proceduar me lidhjen e kontratës.
9. Pas daljes së vendimit të titullarit për projektin/projektet fitues, lidhet kontrata me subjektin fitues bazuar në nevojat dhe udhëzimet e AMA-s. Subjekti hartues i dorëzon projektin, AMA -s, brenda afatit dhe kushteve të parashikuara në kontratë. Projekti i përfunduar, i përcillet për shqyrtim Komisionit të Ndjekjes së Procedurës, i cili shprehet brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja në dorëzim.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë